



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Ndryshimin e Afatit të Përgjigjes ndaj F00358

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Halling

Valeria Boliçi

Xhejms Paç

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në përputhje me nenin 40(2) 40 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 17 dhe 18 shtator 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Mbrojtja e Gucatit") dhe Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("Mbrojtja e Haradinajt") dorëzuan mocione ku kundërshtuan pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve W04841 dhe W04842 të Prokurorit të Specializuar (bashkërisht, "Mocionet").¹
2. Më 24 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Mocioneve.²
3. Më 27 shtator 2021, Trupi Gjykses nxori urdhër me të cilin hodhi poshtë Mocionet ("Urdhri").³
4. Më 29 shtator 2021, edhe Mbrojtja e Gucatit edhe Mbrojtja e Haradinajt bënë kërkesë për rishqyrtimin e Urdhrit ("Kërkesat").⁴
5. Më 7 tetor 2021, Trupi Gjykses i hodhi poshtë Kërkesat ("Vendimi i Kundërshtuar").⁵

¹ F00317, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Kundërshtimin e Pranueshmërisë së Provave sipas Rregullës 138(1)*, 17 shtator 2021, konfidencial. *Shih gjithashtu* F00317/RED, publik. F00318, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë sipas Rregullës 117(2) për Shpallje si të Papranueshme të Dëshmitarëve të ZPS-së*, 18 shtator 2021, konfidenciale.

² F00322, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kundërshtimeve të Mbrojtjes mbi Pranueshmërinë*, 24 shtator 2021, konfidenciale.

³ F00328, Trupi Gjykses, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 27 shtator 2021.

⁴ F00335, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit F00328*, 29 shtator 2021; F00338, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit F00328 mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 29 shtator 2021.

⁵ F00353, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Rishqyrtim të Vendimit F00328*, 7 tetor 2021.

6. Më 12 tetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një kërkesë për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").⁶

II. PARASHTRIMET

7. Në Kërkesën e saj, Mbrojtja e Haradinajt kërkon: (i) leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar; dhe (ii) një urdhër pezullimi sipas rregullës 171 të Rregullores.⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas rregullës 76 të Rregullores, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes, në qoftë se ka një të tillë, dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

9. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Trupi Gjykses, *proprio motu*, mund të shkurtojë afatet e përcaktuara nga Rregullorja.

IV. DISKUTIM

10. Në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, përgjigja ndaj Kërkesës, nëse do të ketë të tillë, duhet të dorëzohet deri më 23 tetor 2021. Duke pasur parasysh se 18 tetori 2021 është data kur planifikohet të fillojë dëshmia e W04841-shit, Trupi Gjykses konstaton se është e nevojshme të shkurtohet deri më 14 tetor 2021 afati për përgjigjen, nëse do të ketë të tillë, me qëllim që Trupi Gjykses të mund të marrë vendim të bazuar mbi informacion para fillimit të dëshmisë së W04841-shit. Për të njëjtën arsye, Trupi Gjykses nuk do të pranojë asnjë kundërpërgjigje.

⁶ F00358, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit F00328*, 12 tetor 2021.

⁷ Kërkesa, para. 51, 56.

V. VENDIM

11. Bazuar mbi sa më lart, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** Mbrojtjen e Gucatit dhe ZPS-në të dorëzojnë përgjigje ndaj Kërkesës, nëse dëshirojnë të bëjnë një gjë të tillë, deri më 14 tetor 2021, në orën 16:00; dhe
- b. **INFORMON** palët se nuk do të pranojë kundërpërgjigje ndaj përgjigjeve, në rast se do të ketë të tilla.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E mërkurë, 13 tetor 2021

Hagë, Holandë